



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:033195

Datë: 08.02.2023

Numri i dokumentit: 03955536

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.52/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, (në objektin e Gjykatës në Veri - Mitrovicë) Kryetari i Trupit Gjykses -gjyqtari Avni Mehmeti, me procesmbajtësen Edita Kelmendi, në çështjen penale kundër të pandehurit; E.J, i akuzuar për veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (më tej KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.nr..... të dt.25.02.2022. Në këtë çështje penale, shqyrtimi fillestar është mbajtur në prezencën e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Naim Beka dhe të pandehurit E.J. Më datën 01.02.2023 ka përfunduar shqyrtimi fillestar, të njëjtën ditë Gjykata e ka shpall publikisht aktgjykimin, ndërsa më dt.08.02.2023, është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI:

E.J nga i ati, e ëma, e vajzërisë, i lindur më dt.00.00.0000 në V..... ku dhe tani jeton në Rr “.....”, ka të kryer shkollën e mesme, është pronar i një kompanie private “.....” në V....., i gjendjes mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal të ID:....., me parë i dënuar dhe zhvillohet edhe procedura tjera penale kundër tij, njëjti;

SHPALLET FAJTOR

SEPSE;

Nga koha e pavërtetuar e deri më dt.03.04.2020 në Rr “.....” në M....., në kundërshtim me Ligjin për armët Nr.05/L-022, pa leje të vlefshme ka poseduar armën e tipit “PAK” e modifikuar nga arma me gazë në armë zjarri, e kalibrit 7.65mm, me numër serik, një karikator dhe gjashtë fishek të cilat janë sekuestruar nga policia.

- Me këtë ka kryer veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 e sanksionuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në mbështetje të nenit 1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 42, 69, dhe nenit 366 par.1 dhe par.3 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365, 366 të KPP-së;

SH Q I P T O N

- DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje 180 (njëqindetëdhjetë) ditë. Ky dënim do të ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- OBLIGOHET i pandehuri E.J të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, dhe shumë prej 50 euro në emër të taksës për Fondit për kompensimin e viktimave të krimi, në tërësi shumë prej shtatëdhjetë (70) euro, të gjitha obligohet t'i paguajnë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Marrja e sendeve;

- URDHËRON konfiskimin i përhershëm të sendeve si në vijim; Arma e llojit armën e tipit PAK e modifikuar nga arma me gazë në armë zjarri, e kalibrit 7.65mm me numër serik, një karikator, gjatë fishek. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi arma dhe sendet tjera përcjellëse të shkatërrohen nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr..... të dt.25.02.2022, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, ndaj të pandehurit E.J, i akuzuar për veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-ës.

Rrjedha e procedurës penale:

Më 01 shkurt 2023, Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve, prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Naim Beka, dhe të pandehurit E.J.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri E.J është deklaruar për fajin dhe kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinimin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prokurori i rastit Naim Beka, ka propozuar që ta aprovohet pranimi i fajësisë i deklaruar nga i pandehuri.

Gjetjet e Gjykatës:

Gjykata në mbështetje të nenit 248 par.4 të KPP-së, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë së të pandehurit E.J, dhe ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e pranimi të fajësisë. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë; raporti fillestar i incidentit i dt.03.04.2020, raportet e oficerit Sh.N dhe M.B, vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve dt.03.04.2020, foto albumi me gjithsejtë tetë (8) fotografi. Të gjitha këto prova janë bindëse dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimi të fajësisë nga i pandehuri, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Gjykata i kishte tërheq vërejtjen të pandehurit se pas pranimi të fajësisë nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë lidhur me gjendjen faktike, është njoftuar se nëse e pranon fajësinë e humbet mundësin e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësin për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë.

Gjykata, gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri E.J është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprën penale për të cilën akuzohet; Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-ës.

- Konfiskimi i armëve:

Në mbështetje të nenit 282 par.1 dhe 2 të KPP-ës, dhe nenit 366 par.3 KPRK-ës, Gjykata ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm e të përhershëm të armës e cila ka qenë në posedim të të

pandehurit. Gjykata ka gjet se i pandehuri E.J, nuk ka poseduar leje të vlefshme e as autorizim për mbajtjen dhe posedimin e armëve. Në anën tjetër, sendet e lartcekura bëjnë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyra automatike nga këto arsye gjykata ka vendosur t'i konfiskoj përherë dhe e njëjta armë ka urdhëruar që të shkatërrohet.

Gjykata vlerëson se në këtë rast plotësohen kushtet dhe kërkesat ligjore për konfiskimin e përhershëm të armëve sipas nenit 366 par.3 të KPRK-ës, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm, për më shumë, konfiskimi ishte propozuar në aktakuzë – dispozita e lartcekur të këtij Kodi, përcakton shprehimisht konfiskimin e detyrueshëm të sendeve të tilla.

- Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin E.J, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, e si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen direkte të tyre, shkallën e përgjegjësisë penale, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tij në këtë vepër penale, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shprehura në Kosovë, rrezikshmërinë që paraqet kjo natyrë e veprave penale, se për një kohë të gjatë i pandehuri ka mbajtur armët pa leje. Si rrethana tjera rënduese, ndaj të pandehurit është vlerësuar edhe e kaluara e tij, sipas të dhënave që kemi siguruar rezulton se i pandehuri është i dënuar për 6 (gjashtë) raste për vepra të ndryshme penale, kundër tij zhvillohen edhe procedura tjera për vepra penale për gjithsejtë 69 (gjashtëdhjetenëntë) raste tjera, në mesin e tyre edhe raste mjaftë serioze, si dhe në 8 (tetë) raste të natyrës se njëjtë, armëmbajtje pa leje dhe përdorim të armëve. Të gjitha këto rrethana tregojnë se kemi të bëjmë me një person që ka një të kaluar kriminale dhe përsëritës i veprave penale nga këto arsye, Gjykata ndaj tij, ka shqiptuar dënim me burgim efektiv, dhe ka refuzuar kërkesën e të pandehurit që dënimi të zëvendësohet me dënim me gjobë.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese ka marrë për bazë faktin se i njëjtit ka treguar sjellje të mira në gjykatë, ka kërkuar falje, se një pjesë të rasteve dyshohet se i ka kryer si i mitur. Ndërsa, si rrethanë tjetër lehtësueses për të pandehurin është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes gjë që ka ndihmuar në zbardhjen e plotë dhe të shpejtë të këtij rasti.

Gjykata bazuar në të cekurave si më lartë beson se dënim që ka shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale dhe rrethanat tjera që janë

Numri i lëndës: 2022:033195

Datë: 08.02.2023

Numri i dokumentit: 03955536

cekur, dënimi është adekuat dhe se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat tjerë, që në të ardhmen të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-ës.

Nga ajo që u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.52/2022 të datës 08.02.2023

Procesmbajtësja:

Edita Kelmendi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.